

CG/BUR02(2016)12

ALEANCA EVROPIANE E QYTETEVE DHE RAJONEVE PËR PËRFSHIRJEN E ROMËVE DHE UDHËTARËVE¹

Udhëzimet strategjike 2016-2019

1. Objektivat

Qëllimi kryesor i Aleancës Evropiane të Qyteteve dhe Rajoneve² për Përfshirjen e Romëve dhe udhëtarëve (më poshtë "Aleanca") është që përmes qyteteve dhe rajone pjesëmarrëse në të, në koordinim me qeveritë përkatëse kombëtare dhe duke pasur parasysh specifikat e secilit vendi, **të favorizojë projekte dhe politika për përfshirjen e romëve dhe udhëtarëve në nivel lokal dhe rajonal.**

Aleanca u krijua në vitin 2013 nga Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës me mbështetjen e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) për Çështjet Rome pas Samitit të Kryetarëve të Bashkive për romët, të organizuar në Strasburg më 22 shtator 2011.

Në përputhje me "Deklaratën e Strasburgut për Romët", të miratuar nga Komiteti i Ministrave i Këshillit të Evropës në tetor të vitit 2010³ dhe Deklaratën Përfundimtare të Samitit të Kryetarëve të Bashkive për Romët "Ndërtimi i besimit në Bazë"⁴, objektivat kryesore të Aleancës janë si më poshtë:

- të krijojë një kuadër për bashkëpunimin, shkëmbimin e praktikave të mira, forcimin e kapaciteteve lokale dhe rajonale për veprim, duke identifikuar problemet specifike dhe duke propozuar zgjidhje. Për këtë arsye Aleanca do të shërbejë si platformë për mbështetje politike, shkëmbime dhe të mësuarit e ndërsjellë duke u përqendruar tek lobimi, mbështetja, nxitja dhe zgjerimi i politikave dhe projekteve rome dhe përfshirja e udhëtarëve;
- të kontribuojë për njohjen e Anticiganizmit si një formë specifike racizmi, duke e dënuar gjuhën e urrejtjes ndaj romëve dhe udhëtarëve dhe duke kufizuar bërjen e deklaratave të tilla⁵;

¹ Termat "Romë dhe Udhëtarë" përdoren në Këshillin e Evropës për të përfshirë një shumëllojshmëri të gjerë të grupeve të mbuluara nga puna e Këshillit të Evropës në këtë fushë: nga njëra anë a) Romët, Sintit/Manushët, Calet, Kaalet, Romanikët, Bojashët / Rudari; b) Egjiptianët e Ballkanit (egjiptianët dhe ashkalitë); c) Grupet lindore (Dom, Lom dhe Abdal); dhe, nga ana tjetër, grupe të tilla si Udhëtarët, Yenishët, si dhe popullata të caktuara që bëjnë pjesë nën termin administrativ "Gens du voyage", si dhe personat të cilët e identifikojnë veten si ciganë.

² Për njësitë administrative të cilat nuk janë qytete ose rajone, shih seksionin 5.1.

³ CM(2010)133, përfundimtar.

⁴ Mund të gjendet në adresën: http://www.coe.int/t/congress/sessions/20110922-roma-summit/default_en.asp

⁵ Cf. Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), Rekomandim i Përgjithshëm për Politikën Nr.13 për luftimin e anticiganizmit dhe diskriminimit kundër romëve.

- të përmirësojë dialogun dhe bashkëpunimin, nga njëra anë ndërmjet autoriteteve lokale dhe rajonale dhe romëve, dhe komuniteteve të udhëtarëve dhe OJQ-ve, duke përfshirë pjesëmarrjen qytetare të tyre në vendimmarrjen e qeverive lokale dhe rajonale; dhe, nga ana tjetër, ndërmjet banorëve lokalë romë dhe udhëtarë dhe pjesës tjetër të popullsisë.

Aleanca bazohet në parimet e qeverisjes së mirë dhe standardet e të drejtave të njeriut siç përcaktohen nga Këshilli i Evropës. Këto parime përfshijnë kërkesën për kufizimin nga gjuha e urrejtjes ndaj romëve dhe udhëtarëve, heqjen e segregimit në shkolla dhe parandalimin e dëbimeve të dhunshme pa sigurimin e akomodimit alternativ. Aleanca është e angazhuar për t'i dhënë një vëmendje të veçantë rolit të romëve dhe udhëtarëve gra dhe romëve dhe udhëtarëve të rinj në promovimin e përfshirjes së romëve dhe udhëtarëve në nivel lokal dhe rajonal. Aleanca është gjithashtu aktive për të nxitur kulturën, gjuhën dhe historinë rome, sidomos kremtimin e Ditës Ndërkombëtare të Romëve (8 prill) dhe Ditës Ndërkombëtare të Gjuhës Rome (5 nëntor), si dhe përkujtimin e Ditës Ndërkombëtare të Përkujtimit (2 gusht) të gjenocidit kundër romëve gjatë Luftës së Dytë Botërore⁶.

2. Sinergjitë

Aleanca mbështet zbatimin e "Planit Tematik të Veprimit për Përfshirjen e Romëve dhe Udhëtarëve (2016-2019)" të Këshillit të Evropës, në veçanti masat që promovojnë zgjidhje të reja në nivel lokal, duke përfshirë programet e përbashkëta me Komisionin Evropian, të tillë si projektin ROMACT⁷ dhe ROMED⁸.

3. Linjat e veprimit⁹

Aleanca ndërmerr aktivitete në katër fusha kryesore:

3.1 Aleanca do të ofrojë një kornizë për të nxitur dhe për të forcuar vullnetin politik të pjesëmarrësve për të punuar për përfshirjen e romëve dhe udhëtarëve. Ajo do të llobojë me aktorë të tjerë lokal, rajonal dhe kombëtar për të nxitur përfshirjen e romëve dhe udhëtarëve. Ndërgjegjësimi në lidhje me standardet evropiane të të drejtave të njeriut, praktikën e mira të përfshirjes së romëve dhe udhëtarëve, si dhe shkëmbimi dhe bashkëpunimi me pjesëmarrësit e tjerë do të ndihmojnë për forcimin e angazhimeve të kryetarëve të bashkive dhe administratorëve, këshilltarëve lokal dhe rajonal dhe stafit të administratës.

3.2 Aleanca do të shërbejë si forum për shkëmbimin dhe bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve lokale dhe rajonale pjesëmarrëse. Ajo do të promovojë të mësuarit reciprok. Në veçanti, Grupi i Punës i Aleancës do t'u vijë në ndihmë pjesëmarrësve për:

- organizimin e seminareve dhe konferencave;
- krijimin e një platforme bashkëpunimi;
- aplikimin për fondet kombëtare dhe ndërkombëtare;

⁶ Njohur si "Pharrajimos", "Porrajimos", "Samudaripen" ose "Kalí Traš" në varësit të variantit në gjuhën rome të përdorur nga komuniteti.

⁷ <http://coe-romact.org/>

⁸ <http://romed.coe-romact.org/>

⁹ Aktivitetet specifike do të jepen në Shtojcë.

- përdorimin e bazës evropiane të të dhënave për politikat dhe praktikat¹⁰ e mira të lidhura me udhëtarët;
- krijimin e partneriteteve të qyteteve;
- vënien në jetë të mësimëve të nxjerra nga projekte të tjera, të tilla si projekti ROMACT dhe ROMED.

Grupi i Punës së Aleancës do të lehtësojë bashkëpunimin me organet e tjera të Këshillit të Evropës, me organizatat dhe rrjetet ndërkombëtare.

- 3.3 Për të komunikuar me median, autoritetet e tjera dhe publikun e gjerë, pjesëmarrësit e Aleancës kërkohet të rrisin vizibilitetin e aktiviteteve që organizojnë për përfshirjen e komuniteteve romë dhe të udhëtarëve, duke kontribuar në fushatën *Dosta!* të Këshillit të Evropës kundër stereotipeve dhe paragjytimeve; duke aplikuar për Çmimin *Dosta!* të Kongresit; dhe duke kremtuar ditët e 8 prillit, 2 gushtit dhe 5 nëntorit me aktivitete të veçanta. Pjesëmarrësit e Aleancës do të inkurajohen të marrin pjesë në aktivitete ndërkombëtare, të tilla si Java kundër Racizmit (mars), Java Ndërkombëtare e Romëve (prill) dhe në Ditën kundër Fashizmit dhe Antisemitizmit (9 nëntor).
- 3.4 Aleanca kërkon të nxisë përfshirjen e shoqërisë civile dhe OJQ-ve që merren me përfshirjen e romëve dhe udhëtarëve në politikat dhe projektet lokale dhe rajonale për përfshirjen e romëve dhe udhëtarëve, nëpërmjet konsultimeve të rregullta, pjesëmarrjes në procedurat e buxhetimit, përfshirjen në aktivitete të pjesëmarrësve të Aleancës dhe promovimin e qytetarisë aktive ndërmjet romëve dhe udhëtarëve të përshkruara në "Kartën Evropiane për Edukimin për Qytetari Demokratike"¹¹.

4. Rezultatet

Aktivitetet e Aleancës dhe pjesëmarrësit e saj pritet të kontribuojnë për arritjen e rezultateve të mëposhtme:

- përmirësimin e përfshirjes sociale të romëve dhe udhëtarëve, si dhe uljen e qëndrimeve diskriminuese dhe gjuhës së urrejtjes ndaj romëve dhe udhëtarëve duke i përdorur qytetet dhe rajonet pjesëmarrëse në Aleancë si modele për t'u ndjekur;
- përmirësimin e dialogut ndërmjet autoriteteve lokale dhe rajonale dhe komuniteteve dhe OJQ-ve të romëve dhe udhëtarëve, si dhe një pjesëmarrje më të mirë qytetare nga komunitetet romë dhe të udhëtarëve;
- rritjen e numrit të qyteteve dhe rajoneve që krijojnë masa efektive për të nxitur përfshirjen sociale të romëve dhe udhëtarëve në nivel lokal dhe rajonal;
- shpërndarjen e metodave të provimit dhe testimit dhe mjeteve për bashkëpunim, të mësuarit e ndërjellë dhe përkrahjen e qyteteve dhe rajoneve në këtë fushë;
- përmirësimin e aksesit në burimet financiare ekzistuese në dispozicion për zbatimin e politikave të integruara;
- përmirësimin e potencialit për sinergji me qytete dhe rajone të tjera për transferimin e ekspertizës dhe të mësuarit reciprok, duke përfshirë rrjetet kombëtare të qyteteve.

¹⁰ <http://goodpracticeroma.ppa.coe.int/en>

¹¹ Rekomandimi CM/Rec(2010)7 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare në Kartën Evropiane të Këshillit të Evropës për Edukim për Qytetari Demokratike dhe Edukim për të Drejtat e Njeriut.

5. Struktura

Aleanca është krijuar nga Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale. Ajo operon në përputhje me procedurat e përgjithshme të Kongresit dhe mbikëqyret nga Byroja e Kongresit. Që nga janari i vitit 2016, menaxhimi operacional i Aleancës i është besuar Ekipit Mbështetës të PSSP-së për çështjet e romëve, ndërsa Kongresi mbulon mbështetjen politike dhe financiare për të.

Në mënyrë të veçantë Kongresi do të vazhdojë t'i japë prioritet të lartë çështjes së përfshirjes së romëve në nivel lokal, nëpërmjet punës së Komitetit të Çështjeve Aktuale dhe raportuesit e saj tematik për romët. Ai do të vazhdojë të organizojë, çdo dy vjet, çmimin "Dosta!" për bashkitë të cilat kanë zbatuar praktika të mira në fushën e përfshirjes së romëve, dhe do t'i kushtojnë vëmendje të veçantë ndjekjes së Rezolutave dhe Rekomandimeve të saj për "Gjendjen e romëve në Evropë: sfidë për autoritetet lokale dhe rajonale"¹² (tetor 2011) dhe "Fuqizimin e të rinjve romë përmes pjesëmarrjes: projektimi i politikave efektive në nivelin lokal dhe rajonal"¹³ (mars 2014).

5.1 Pjesëmarrësit në Aleancë

Pjesëmarrës në Aleancë janë autoritetet lokale dhe rajonale të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës të cilët janë angazhuar për të nxitur përfshirjen e romëve dhe udhëtarëve dhe për të vënë në jetë objektivat dhe parimet e Aleancës.

Pjesëmarrja në Aleancë është e hapur për të gjitha subjektet në nivelet nënkombëtare, d.m.th. për rrethet, departamentet, rajonet, bashkitë, qytetet, njësitë bashkiake ose komunale, lagjet, seksioneve etj.; pjesëmarrja nuk kufizohet vetëm për qytetet dhe rajonet në kuptimin e ngushtë të tyre. Subjekteve të interesuara pjesëmarrëse u kërkohet të shprehin angazhimin e tyre me anë të një letre që një përfaqësues i zgjedhur i dërgon Presidentit të Kongresit.

Pjesëmarrja e plotë në Aleancë kryhet në bazë të kriterëve të veçanta, duke përfshirë:

- angazhimin e qartë për të kapërcyer problemet ekzistuese në lidhje me situatën e romëve dhe udhëtarëve (p.sh. një angazhim i shprehur për politikën dhe një strategji bazë për integrimin lokal ose rajonal);
- demonstrimin e përpjekjeve aktuale ose të bëra në të shkuarën në favor të përfshirjes së romëve dhe udhëtarëve;
- mekanizmat ekzistues për dialog dhe bashkëpunim me komunitetet lokale romë dhe të udhëtarëve.

Pjesëmarrësit duhet të mbështesin parimet udhëheqëse të pjesëmarrjes në Aleancë.

Sekretari i Përgjithshëm i Kongresit së bashku me PSSP-në për çështjet romë, pas konsultimeve të rregullta me pjesëmarrësit në fjalë dhe pasi të jetë informuar nga Byroja e Kongresit, ka të drejtë të përjashtojë nga Aleanca çdo pjesëmarrës që bie në kundërshtim me parimet udhëheqëse të Aleancës – siç parashikohet në paragrafin e fundit të pjesë 1 tek "Objektivat" më sipër, ose që vë në rrezik besueshmërinë e Aleancës dhe aktivitetet e Këshillit të Evropës që promovojnë përfshirjen e romëve dhe udhëtarëve.

¹² Mund të gjendet në adresën: <https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?id=1855297>

¹³ Mund të gjendet në adresën:

<https://wcd.coe.int/ViewDoc.jsp?Ref=CG%2826%298FINAL&Language=lanEnglish&Ver=original&Site=COE&BackColorInternet=C3C3C3&BackColorIntranet=CACC9A&BackColorLogged=EFEA9C>

Pas konsultimit të pjesëmarrësve në Aleancë, Sekretari i Përgjithshëm i Kongresit, së bashku me PSSP-në për çështjet e romëve, mund të propozojë nënshkrimin e një Karte nga pjesëmarrësit e Aleancës ku specifikohen detyrimet dhe angazhimet e tyre, nëse del nevoja për një rregullim më specifik.

5.2 Grupi i Punës

Aleanca ndihmohet nga një Grup Pune i ngritur brenda Ekipit të Mbështetjes së PSSP-së për çështjet e romëve, me seli në Strasburg.

Grupi i Punës është përgjegjës për t'i ndihmuar pjesëmarrësit në aktivitetet e tyre dhe zbaton aktivitete në konsultim të ngushtë me Sekretariatit e Kongresit dhe pjesëmarrësit e Aleancës. Aktivitetet e Grupit të Punës orientohen nga rezultatet dhe nxiten nga nevojat e pjesëmarrësve të Aleancës. Programi i aktiviteteve jepet në një shtojcë të veçantë.

6. Funksionimi

Gjuhët zyrtare të Aleancës janë gjuhët zyrtare të Këshillit të Europës. Përdoren dhe gjuhë të tjera pune, sipas mundësisë, për të siguruar komunikim efektiv me pjesëmarrësit dhe partnerët.

Aktivitetet e Aleancës mund të financohen nga burimet e mëposhtme:

- buxheti i zakonshëm i Këshillit të Europës (i Kongresit dhe PSSP-së për romët).
- kontributet nga pjesëmarrësit e Aleancës, p.sh. përmes organizimit së aktiviteteve të veçanta;
- kontributeve vullnetare nga shtetet anëtare;
- programet e përbashkëta me Komisionin Evropian (për miratim paraprak nga Komisioni Evropian);
- kontributet nga donatorë të tjerë, duke përfshirë organizatat e tjera ndërkombëtare dhe organizatat e shoqërisë civile.